

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E MARTË 1 NËNTOR 2022

Në vazhdim të komenteve nga dita e djeshme, gjatë referimit tuaj ju thatë se në programet e hartuara dhe të aplikuara gjatë vitit 2022 nga Agjencia Kombëtare e Rinisë keni aksesuar rreth 1500 të rinj, ndërkohë që sot, meqë e kam numrin e saktë, kemi 615 352 të rinj. A është ky një numër i mjaftueshëm që të gjitha këto programe që i menaxhoni gjatë 1 viti të aksesojnë një numër kaq të vogël të rinjsh? Çfarë targeti ka pasur zgjedhja e kësaj fashe, pra që janë zgjedhur 1500 të rinj nga Agjencia Kombëtare? Si janë përzgjedhur dhe çfarë kanë përfutur këta të rinj nga përfshirja në këto programe që keni realizuar ju? Këtu kam pasur parasysh emergjencën, sepse për mua është emergjent largimi i të rinjve.

A ka ndonjë program specifik, përveçse atyre të sportit, artit dhe zejeve që synon që këta të rinj të kenë mundësi të arsimohen dhe të rrinë në Shqipëri? Unë nuk besoj se janë sporti, arti dhe zejtaria që i mbajnë fëmijët tanë, por është cilësia e arsimit, natyrisht edhe mbështetja buxhetore nga buxheti i shtetit me bursa të plota të paktën për të rinjtë ekselencë gjatë viteve para, por edhe më tej gjatë studimeve. Ju thatë se nuk keni një shifër të saktë sa parashikohet në buxhetin e një shteti apo sa parashikon qeveria për një të ri. Në fakt, ne dimë që të ardhurat e një individi në Shqipëri për të jetuar janë 5,5 dollarë në ditë. Kjo është shifra që u shkon edhe të rinjve për të jetuar, pra kaq janë të ardhurat edhe për një të ri për të jetuar në Shqipëri?

Ju thoni që 50 mijë lekë të vjetra janë suport për një të ri, por, në fakt, vetëm për të bërë transportin nga Elbasani në Tiranë nuk do t'i mjaftonin këto para nëse do të ndjekë universitetin në Tiranë. Mua më duken si programe koeficiente ose nuk është zgjedhur fusha e përshtatshme për t'i mbuluar ato në mënyrë që të rinjtë të rinë këtu. Natyrisht, mungojnë sporti, arti dhe zejtaria, por këto nuk janë prioritete emergjente në situatën në të cilën ndodhemi sot ku largimi i të rinjve është në mënyrë drastike, duke pasur parasysh edhe shifrat nga viti 2017 deri në vitin 2022. Ka disa faktorë që kanë ndikuar siç është lindshmëria e disa të tjerë, por besoj se largimi është faktori kryesor në rënien e numrit të të rinjve. Jam në pritje të komentit nga ana juaj.